



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:073688

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05744251

C.nr.700/2020

GJYKATA THEMELORE PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil Gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridike të paditësit Kompania Kosovare për distribuim&furnizim me energji elektrike sh.a KEDS me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtarja ligjore G.H. kundër të paditurit S.O.K. N.T.SH-..... nga fshati Komuna Suharekë, me objekt të padisë për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 10.556.05 euro, me datë 28.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Themelore në Prizren, shpallet **jokompetente në pikëpamje territoriale**, për të vendosur në këtë çështje juridike.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen **Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Suharekës**, si gjykatë kompetente në pikëpamje territoriale.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është parashtruar padia nga ana e paditësit Kompania Kosovare për distribuim&furnizim me energji elektrike sh.a KEDS me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S.O.K. N.T.SH. nga fshati Komuna Suharekë, me objekt të padisë për kompensimin e dëmit material.

Në bazë të nenit 37.1 të LPK-së, është paraparë se “Në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur” ndërsa me nenin 38.1 të LPK-së, parashihet që “Për procedimin e çështjes juridike është e kompetencës së përgjithshme territoriale gjykata në territorin e të cilës i padituri e ka vendbanimin”.

Gjykata konstaton se në këtë çështje kontestimore i padituri S.O.K. është me vendbanim në fshatin,Komuna Suharekë.

Ndërsa, për pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi gjykata vendosi bazuar në nenin 392 të LPK-së, i cili në mënyrë decisive thotë “*Pas shqyrtimit të padisë gjykata me aktvendim shpallet jokompetente dhe lëndën ia dërgon gjykatës për të cilën mendon se është*

Numri i lëndës: 2020:073688
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05744251

kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi, po që se konstaton: a) se nuk është e kompetencës territoriale për gjykimin e çështjes”.

Andaj, duke pasur për bazë këto dispozita ligjore, të cilat përcaktojnë kompetencën për zgjidhjen e kontesteve, në rastin konkret këtu i padituri S.O.K. është me vendbanim në fshatin Komuna Suharekë, gjykata ka konstatuar se kemi të bëjmë me çështje juridiko-kontestimore, e cila është kompetencë territoriale e Departamenti të përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega Suharekë.

Andaj, në bazë të kësaj gjendje faktike, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke ju referuar nenit 37.1, 38.1 lidhur 392 pika (a) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.700/20 me datë 28.05.2020**

**Gj y q t a r j a
Edije Sezairi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.